



BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI 2024- 2025

Nëntor 2025



www.ahc.org.al

BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI 2024-2025

Tiranë, Nëntor 2025

Zbatimi i metodologjisë dhe përgatitja e raportit:

Z. Vladimir Karaj, gazetar

Znj. Ola Mitre, gazetare

Redaktim ligjor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KSHH

Z. Niazo Jaho, Këshilltar ligjor, KSHH

Znj. Nosiana Burnazi, Paraligjore & Asistente Projektesh, KSHH

Publikuar nga:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rruga "Brigada e VIII", Kulla

"Tekno Projekt", Shkalla 2,

Apartamenti 10, Kati 6



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

© 2025 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky raport u hartua në kuadër të mbështetjes institucionale të ofruar nga Fondacioni Sigrid Rausing Trust.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Sigrid Rausing Trust.

TABELA E PËRMBAJTJES

BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI 2024-2025.....	0
1. Hyrje	3
2. Përmbledhje ekzekutive	5
3. Metodologjia	7
3.1 Të dhëna të përgjithshme për të anketuarit.....	8
4. Respektimi i të drejtave të punonjësve të medias në vendin e punës	8
4.1 Informaliteti dhe kushtet e punës	9
4.2 E drejta për pushime javore dhe vjetore	10
4.3 Bullizmi/tallja në vendin e punës	11
4.4 Ngacmimet seksuale në vendin e punës	12
4.5 Organizimi sindikal	12
5. Liria profesionale dhe siguria.....	14
5.1 Kërcënimet për shkak të punës	15
5.2 Stresi dhe situatat traumatike	16
5.3 Mbështetja institucionale	16
6. Censura dhe vetëcensura	16
6.1 Censura e drejtpërdrejtë: harta e temave të ndaluara	17
6.2 Presioni për raportim jo etik	18
6.3 Vetëcensura.....	19
7. Vlerësimi i përgjithshëm mbi lirinë e medias	19
7.1 Perceptimi i lirisë dhe tendenca	20
7.2 Faktorët ndikues	21
7.3 Ngjarjet kryesore dhe zhvillimet pozitive	22
7.4 Aksesit në drejtësi	23
7.5 Perceptimi mbi gazetarinë cilësore	24
8. Rekomandime.....	24
8.1 Rekomandime për përfaqësuesit e organeve publike dhe partive politike	24
8.2 Rekomandime për pronarët e medias	25
8.3 Rekomandime për Sindikatën e Gazetarëve si dhe organizatat e shoqërisë civile vendase dhe të huaja.....	25

1. Hyrje

Në përputhje me misionin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ky raport, i cili vjen në formën e një Barometri të implementuar nga KShH prej vitit 2020, publikon gjetjet dhe rekomandimet mbi respektimin e Lirisë së Medias në Shqipëri, për periudhën 2024-2025. Shqetësimet dhe problematikat e pasqyruara në këtë Barometër janë vijim i një serie raportesh të mëparshme të organizatave të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, ndërkohë që Barometri fokusohet posaçërisht tek të dhënat e mbledhura nga një sondazh i thelluar me 202 gazetarë dhe punonjës të medias në Shqipëri. Ai ofron një vlerësim sasior dhe cilësor mbi kushtet e tyre të punës, lirinë profesionale, sigurinë dhe perceptimet e tyre mbi ekosistemin mediatik në Shqipëri.

Ky raport hartohet në një kontekst kompleks kombëtar dhe ndërkombëtar dhe në dukje kontradiktor për lirinë e medias në Shqipëri. Nga njëra anë, Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2024 i "Reporterëve pa Kufij" (RSF) e renditi Shqipërinë në vendin e 80-të, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm me 19 vende krahasuar me vitin 2023¹². Vetë RSF ia atribuoi këtë rritje përmirësimeve në kuadrin ligjor, sigurisë dhe aspektit social. Megjithatë, i njëjti raport theksonte se treguesit politikë dhe ekonomikë u përkeqësuan dhe se liria e shtypit "kërcënohet nga lidhjet e ngushta midis botës së biznesit dhe politikës" dhe "frikësimet nga politikanët dhe krimi i organizuar" ¹.

Ky vlerësim i përmirësuar vetëm në disa kritere haset edhe te vëzhgues të tjerë ndërkombëtarë. Komisioni Evropian (KE) në Raportet për Shqipërinë 2024 dhe 2025 vë në dukje ose "mungesë progresi" ose "progres të limituar". Raporti i KE 2024 thekson "mungesë progresi" në adresimin e sfidave kryesore, duke përfshirë "përqendrimin e lartë të tregut, mbivendosjen e interesave të biznesit dhe politikës, mungesën e transparencës së burimeve të financimit" dhe pavarësinë e pamjaftueshme të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)³.

Ndërkohë raporti për vitin 2025 rithekson të njëjtat probleme, duke vënë në dukje mungesën e ndërhyrjeve përmirësuese domethënëse. "Situata në përgjithësi mbetet e pandryshuar, me pavarësinë dhe pluralizmin e medias që vazhdojnë të ndikohen nga mbivendosja e interesave të biznesit dhe atyre politikë, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, frikësimi dhe kushtet e pasigurta të punës për gazetarët."⁴

Gjithashtu, KE vë në dukje në raport se shpifja mbetet një vepër penale. Përkundër kësaj kërkesë, drafti i ri i Kodit Penal i propozuar për shqyrtim në verë 2025 sipas ekspertëve e përkeqësonte situatën, duke shtuar

¹ Indeksi i lirisë së medias/ Reporterët pa Kufi, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://rsf.org/en/country/albania>

² Raporti i Reporterëve pa Kufij, ku renditet Shqipëria në indeksin e lirisë së medias, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://euronews.al/raporti-i-reportereve-pa-kufij-ku-renditet-shqiperia-ne-indeksin-e-lirise-se-medias/>

³ EUROPEAN COMMISSION Brussels, 30.10.2024 SWD(2024) 690 ..., aksesuar më 3 Nëntor 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

⁴ Albania Report 2025 (Komisioni Evropian), aksesuar më 3 Nëntor 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2025_en

dënime dhe për fyerjen dhe duke rritur mbrojtjen ndaj kritikës në media për figurat me pushtet⁵. Megjithatë, këto pjesë të draftit të ri mund të mos miratohen. Ministria e Drejtësisë ka dhënë sinjale se ndryshimet në lidhje me shpifjen do përfshihen në një projekt të veçantë që kërkon përafrimin me legjislacionin dhe standartet e BE-së që heq kriminalizimin.

Në mënyrë të ngjashme, raportet nga rrjeti SafeJournalists (SJ)⁶ dhe BIRN Albania e Qendra për Shkencë dhe Zhvillim (SCiDEV) flasin për “sfida strukturore” të thella dhe “kapje të medias”⁷. Raporti i Centre for Media Pluralism and Media Freedom, CMPF mbi pluralizmin e vlerëson lirinë dhe pluralizmin e medias në Shqipëri si “në rrezik të lartë”⁹. SafeJournalists Network (SJN) regjistroi 41 shkelje të veçanta ndaj lirisë së medias në vitin 2024 dhe 39 të tilla deri në nëntor të vitit 2025, duke përfshirë sulme verbale dhe sulme fizike¹⁰. Po ashtu organizatat ndërkombëtare kanë shprehur vazhdimisht shqetësim për praktikat kufizuese të institucioneve përfshirë prokurorinë ndaj gazetarëve dhe kufizimet e vazhdueshme të aksesit të gazetarëve në parlament¹¹.

Tërthorazi raportimi i OSBE-ODHIR për zgjedhjet e majit 2025 vuri në dukje një sërë problemesh që vazhdojnë të ekzistojnë në mënyrë sistematike në mjedisin e medias në Shqipëri. Vëzhguesit theksuan vijimin e traditës së keqe të materialeve të gatshme nga partitë politike dhe mungesën e pluralizmit dhe raportimit thelbësor gjatë fushatës zgjedhore. Liria e munguar e medias ishte një nga elementet me ndikim negativ në zgjedhjet e fundit¹². “Mjedisi mediatik mbeti i kufizuar në mënyrë të theksuar, me pavarësinë, diversitetin dhe integritetin e përmbajtjes së lajmeve të cenuara nga financimet jotransparente, përqendrimin e pronësisë, ndërhyrjet në autonominë editoriale dhe ndikimin politik. Mungesa e raportimit të pavarur ka dobësuar rolin mbikëqyrës të medias, ndërsa gazetaria kritike dhe informacioni i thelluar vazhdojnë të mungojnë”¹².

Këto gjetje u mbështetën edhe nga vëzhgimi që KShH i bëri zgjedhjeve parlamentare të datës 11 maj 2025, ku u vu në pah se në aspektin mediatik, pavarësisht përpjekjeve për të siguruar një trajtim të barabartë të subjekteve politike në transmetimet televizive si dhe dedikimit të kohës më të kufizuar dhe joproporcionale

⁵ “Cenon lirinë e shprehjes”, organizatat e medias kritikojnë ndryshimet e Kodit Penal (Reporter.al), aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://www.reporter.al/2025/08/01/cenon-lirine-e-shprehjes-organizatat-e-medias-kritikojne-ndryshimet-e-kodit-penal/>

⁶ SafeJournalists Network, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://safejournalists.net/>

⁷ Albania – Indicators on the Level of Media Freedom and Journalists' Safety Index 2023 - SCiDEV, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/ALB-ENG-2024.pdf>

⁸ Media Freedom in Albania: Shadow Report 2024 - SCiDEV, aksesuar më 3 Nëntor 2025, https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/07/ENG_Media-Freedom-Shadow-Report_ALBANIA.pdf

⁹ Raporti: Liria dhe pluralizmi i medias në Shqipëri është në ‘rrezik të lartë’ (Reporter.al), aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://www.reporter.al/2024/06/28/raporti-liria-dhe-pluralizmi-i-medias-ne-shqiperi-eshte-ne-rrezik-te-larte/>

¹⁰ Incidents Dashboard – Albania (SafeJournalists Network), aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://safejournalists.net/incidents/>

¹¹ Open Letter on Improving Journalists' Access to the Albanian Parliament - Media Freedom Rapid Response, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://www.mfrr.eu/open-letter-on-improving-journalists-access-to-the-albanian-parliament/>

¹² PARLIAMENTARY ELECTIONS 11 MAY 2025 ODIHR Election Observation Mission Final Report [osce.org/files/f/documents/0/c/600028.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/0/c/600028.pdf), aksesuar më 3 Nëntor 2025.

nga disa televizione për partitë e vogla garuese, interesat e ndërlidhura midis qeverisë, biznesit dhe medias krijuan sërisht një mjedis të pabarabartë dhe avantazhues ndaj dy forcave kryesore politike¹³.

Në këtë sfond, ky Barometër, dhe krahasimi i tij me të dhënat e Barometrit 2022-2023¹⁴ e 2021¹⁵, bëhet thelbësor. Ai kërkon t'i japë përgjigje kësaj paqartësie duke matur drejtpërdrejt përvojën e jetuar të gazetarëve dhe punonjësve të medias në Shqipëri. Gjetjet e këtij sondazhi ofrojnë një pamje më të zymtë, e cila rreshtohet më afër me raportet e Freedom House¹⁶ dhe Komisionit Evropian, duke zbuluar një realitet të prekshëm të pasigurisë ekonomike, presioneve editoriale dhe një ndjenjë të përgjithshme të përkeqësimit të lirisë profesionale.

2. Përmbledhje ekzekutive

Barometri i Lirisë së Medias 2024-2025 konfirmon se, pavarësisht disa ndryshimeve në tregues të caktuar, perceptimi i përgjithshëm i komunitetit të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias mbetet thellësisht negativ, teksa kushtet e punës vijnë të jenë të paqëndrueshme. Të dhënat e sondazhit, ku morën pjesë 202 punonjës të medias, tregojnë se ndërsa sulmet fizike mund të jenë ulur, presioni strukturor, ekonomik dhe editorial është rritur, duke çuar në nivele të larta të censurës së drejtpërdrejtë dhe vetëcensurës së vazhdueshme.

Në raportin e këtij viti, të dhënat cilësore sjellin dëshmi të drejtpërdrejta nga gazetarët lidhur me ngjarje sensitive dhe konflikte të vazhdueshme me aktorë të fuqishëm politikë dhe institucionalë. Punonjësit e medias raportojnë se censura dhe vetëcensura lidhen shpesh me çështje të profilin të lartë, ku raportimi është shoqëruar me presion, pengesa redaksionale apo orientim editorial. Rastet e përmendura më shpesh përfshijnë "Inceneratorët", çështjen "Veliaj" dhe "Arrestimet e drejtorëve të Bashkisë Tiranë", "aferat e spitalit Onkologjik", "ekspozimin e parregullsive në sistemin TIMS", "projektin e Aeroportit të Vlorës" apo "dosje të hetuara nga SPAK".

Gjetjet kryesore të këtij raporti janë si më poshtë:

- **Perceptimi i përgjithshëm:** Komuniteti i gazetarëve mbetet pesimist. Një shumicë dërrmuese prej 70.8% e të anketuarve e vlerëson median si "Pak të lirë" ose "Aspak të lirë". Në mënyrë domethënëse, 58.4% e të anketuarve besojnë se situata e lirisë së medias është përkeqësuar gjatë periudhës së fundit, kundrejt vetëm 11% që besojnë se është përmirësuar. Kjo gjetje, e bazuar në "përvojën personale" (55.4%), bie ndesh drejtpërdrejt me përmirësimin e raportuar në renditjen e RSF 2024. Një pjesë e konsiderueshme, 36.1%, vlerësojnë se situata nuk ka pësuar asnjë ndryshim, që në praktikë nënkupton vazhdimësi të një realiteti problematik. Kjo pasi edhe në vitet e mëparshme liria e medias është perceptuar gjerësisht si "pak" ose "aspak e lirë".

¹³ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2025/08/Raport-Perfundimtar-Per-vezhgimin-e-Zgjedhjeve-Parlamentare-te-dt.-11-Maj-2025.pdf>

¹⁴ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2024/12/BAROMETRI-I-MEDIAS-FINAL-PDF.pdf>, aksesuar më 3 Nëntor 2025.

¹⁵ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf

¹⁶ Albania: Freedom in the World 2024 Country Report, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024>

- **Përkeqësimi i kushteve të punës:** Pasiguria dhe informaliteti mbeten mjete kontrolli. Ndërsa ka një rritje të gazetarëve apo punëtorëve të medias me një kontratë formale edhe përqindja e punonjësve të medias që punojnë pa një kontratë të rregullt pune është rritur në 12.9%, krahasuar me 9.9% në Barometrin 2022-2023 dhe 6% në 2021. Mbi 16% e gazetarëve ende nuk e marrin pagën e plotë në bankë, duke i ekspozuar ata ndaj presioneve ekonomike.
- **Mjedisi i punës dhe bullizmi:** Fenomeni i bullizmit, i raportuar nga 9.4% e të anketuarve, zërthehet më mirë në këtë raport. Të dhënat cilësore tregojnë se ai përdoret si një mjet menaxherial dhe ekonomik. Të anketuarit raportojnë "tallje për mosmarrjen e pagesës në kohë" dhe dëshmi të "pronarëve që poshtërojnë kolegët për të shmangur rritjen e pagave".
- **Ndryshimi i natyrës së kërcënimit:** Ndërsa kërcënimet fizike të raportuara janë ulur (nga 20.3% në 2022-2023 në 14.4%), kërcënimet verbale janë në rritje të ndjeshme (nga 31.2% në 2022-2023 në 37.1% në 2024-2025). Të dhënat e reja cilësore tregojnë se kërcënimet po bëhet më i sofistikuar, duke kaluar nga dhuna e hapur në presione ligjore (padi SLAPP nga zyrtarë publikë) dhe presione të brendshme menaxheriale ("bëje ose largohesh").
- **Rritja e censurës së drejtpërdrejtë:** Përqindja e gazetarëve që raportojnë se janë ndaluar nga eprorët për të publikuar një lajm është rritur në 38.1%, nga 31% në raportin 2022-2023. Të dhënat e reja cilësore ofrojnë dëshmi specifike që kjo censurë lidhet drejtpërdrejt me skandale të profilit të lartë, duke përfshirë rastin e inceneratorëve, çështjen "Veliaj" dhe "arrestimin e drejtorëve të "Bashkisë Tiranë", skandalin e spitalit Onkologjik dhe atë të TIMS. Një sfidë thelbësore në parandalimin dhe luftimin e censurës mbetet mosraportimi i saj në mënyrë të drejtpërdrejtë në publik, ndonëse vetë misioni i gazetarëve lidhet me informimin dhe transparencën ndaj publikut. Frika për pasigurinë në vendin e punës është faktori kryesor që i pengon gazetarët të raportojnë raste të censurës. Në mënyrë të ngjashme, edhe mungesa e reagimit të duhur institucional në raste të tjera të ndjeshme, si veprat penale kundër gazetarëve, e thellon më tej këtë hezitim dhe krijon një mjedis ku abuzimet mbeten të pashqiptuara.
- **Modeli i propagandës:** Përveç censurës, një shifër alarmante prej 42.6% e gazetarëve raportojnë se janë urdhëruar të publikojnë lajme të gatshme pa i kontrolluar ato. Vetë gazetarët e identifikojnë këtë përmbajtje si "Propagandë ose material promovues" (40.9%) dhe "Informacion zyrtar" (32.7%), duke konfirmuar gjetjet e raporteve të jashtme për "përmbajtje mediatike të parapërgatitur".
- **Vetëcensura kronike:** vetëcensura mbetet në nivele të pandryshuara dhe alarmante. 46.5% e gazetarëve pranojnë se kanë shmangur raportimin e një lajmi nga frika e eprorit, një shifër pothuajse identike me atë të 2022-2023 (47.0%).
- **Diagnoza e sektorit:** Pyetjet e këtij Barometri ofrojnë një diagnozë të qartë të problemit nga vetë gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri. Ata identifikojnë "Ndërhyrjet e qeverisë/partive politike" (80.2%) dhe "Interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët" (68.3%) si pengesat kryesore. Rrjedhimisht, ata propozojnë si zgjidhje pavarësinë financiare ("Mbështetja nga donacionet e huaja", 55.4%) dhe fuqizimin kolektiv ("Krijimi i sindikatave", 54.5%).
- **Perceptimi mbi cilësinë e raportimit:** Përqindja e gazetarëve që vlerësojnë se cilësia e raportimit është përkeqësuar është rritur me në mënyrë të konsiderueshme (8%), nga 43.6% në vitin 2023 në 51.5% vitin 2024-2025.
- **Perceptimi për zhvillimet pozitive:** Shumica e të anketuarve nuk përmendën asnjë të tillë, ndërsa të paktat zhvillime të përmendura si pozitive lidhen me faktorë të jashtëm, kryesisht aksionet e SPAK dhe arrestimet e politikanëve të profilit të lartë.

- **Pengesa kryesore për lirinë e medias:** Shumica dërmuese e të anketuarve identifikojnë politikën dhe politikanët si burimin kryesor të presionit, duke përmendur sulmet verbale nga zyrtarë të lartë dhe raste të ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, përfshirë dëbimin e gazetarëve të Focus Media Group nga godina.

3. Metodologjia

Të dhënat e këtij Barometri janë mbledhur duke përdorur metodën e sondazhit, realizuar përmes një pyetësoi elektronik të detajuar (i përbërë nga 62 pyetje të mbyllura dhe të hapura), i cili iu shpërnda një kampioni të gjerë gazetarësh dhe punonjësish të medias. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave ndjek praktikën e Barometrave të mëparshëm, duke garantuar anonimin e të anketuarve, për të nxitur përgjigje të sigërta dhe të pandikuara.

Në total, interesit për Barometrin 2024-2025 i janë përgjigjur 202 punonjës të sektorit të medias, një kampion i ngjashëm me raportet e shkuara. Ky raport analizon si të dhënat sasiore të mbledhura, ashtu edhe përgjigjet cilësore ndaj pyetjeve të hapura, veçanërisht ato të shtuara rishtazi në këtë edicion të Barometrit. Përgjatë analizës, përdoret metoda krahasimore me të dhënat e Barometrit 2022-2023 për të gjurmuar ndryshimet dhe tendencat në situatën e lirisë së medias në Shqipëri.

Sondazhi u realizua gjatë periudhës tetor 2025, por të dhënat e tij i referohen periudhës 2024-2025.

Vijon i njëjti shqetësim i përmendur edhe në Barometrat e mëparshëm për mungesën e të dhënave të sakta lidhur me numrin total të punonjësve të sektorit të medias në vendin tonë. Referuar të dhënave të mbledhura më herët nga ekspertë të fushës dhe organizata të shoqërisë civile, përllogaritet se numri i punonjësve të medias varion mes 6200 dhe 5900 persona. Të dhënat e rrjedhura në vitin 2022 nga databaza e pagave për vitin 2021 jepnin një numër edhe më të ulët të punonjësve në media. Sipas kësaj databaze në media të ndryshme kishte rreth 2500 punonjës. Diferencat mund të shpjegohen edhe nga fakti se databaza përfshinte të dhëna zyrtare të raportuara nga vetë institucionet, të cilat u publikuan në mënyrë të paautorizuar nga sistemi i AKSHI-t. Për shkak të mungesës së një kategorizimi të brendshëm sipas sektorëve, si dhe përjashtimeve të mundshme në raportimet institucionale, ky burim ka gjasa të mos pasqyrojë plotësisht përmasën reale të punësimit në media.

Metodologjia e kampionimit ka si qëllim gjithëpërfshirjen e gazetarëve dhe punonjësve të medias, duke marrë në konsideratë elemente si gjinia dhe shpërndarja gjeografike, ku të anketuarit ishin të pozicionuar në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Lezhës dhe Dibrës.

Pyetjet janë organizuar në 3 blloqe të ndryshme:

- Blloku i parë mbledh të dhëna konkrete mbi kushtet dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës (marrëdhënia kontraktuale, kohëzgjatja, pushimet, nevoja për sindikatë).
- Blloku i dytë mbledh të dhëna mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale (kërcënimet, stresi, ndikimi i eprorëve).
- Blloku i tretë përmban pyetje për mbledhjen e të dhënave mbi faktorët që sipas punonjësve të sektorit ndikojnë në lirinë e medias dhe sugjerimet e tyre.

3.1 Të dhëna të përgjithshme për të anketuarit

Karakteristikat demografike dhe profesionale të 202 të anketuarve ofrojnë një pasqyrë të kampionit të këtij studimi:

- **Gjinia:** Kampioni ruan një balancë gjinore, me 51% (103) të anketuar që identifikohen si femra dhe 49% (99) si meshkuj.
- **Mosha:** Pjesa më e madhe e të anketuarve janë në moshë aktive profesionale. Grupmosha më e madhe është 30-40 vjeç (38.1%), e ndjekur nga 40-50 vjeç (31.2%) dhe 20-30 vjeç (24.3%).
- **Përvoja:** Kampioni përbëhet kryesisht nga gazetarë me përvojë të gjatë. 62.4% e të anketuarve kanë mbi 10 vite përvojë në gazetari (44.1% kanë mbi 15 vjet dhe 18.3% kanë 10-15 vjet). Kjo tregon se përgjigjet vijnë nga individë me një kuptim të thellë dhe afatgjatë të sektorit.
- **Pozicioni i punës:** Pjesa dërmuese e të anketuarve janë gazetarë (61.4%), të ndjekur nga kryeredaktorë (10.4%) dhe redaktorë (9.4%).
- **Lloji i medias:** Sektori televiziv mbetet punëdhënësi kryesor, me 72.3% të të anketuarve që punojnë në TV, i ndjekur nga portalet online me 11.9%. Mediat e shkruara (gazetat) përbëjnë vetëm 4% të kampionit.
- **Shtrirja dhe vendndodhja:** Kampioni është kryesisht urban dhe kombëtar. 74.8% punojnë në media kombëtare dhe 87.1% e zhvillojnë profesionin e tyre nga Tirana. Këto të dhëna tregojnë një përqendrim edhe më të madh të medias në kryeqytet dhe mungesën e saj në rrethe¹⁷, pavarësisht se numri i të pyeturve që punojnë në media lokale u rrit nga barometri i mëparshëm.

4. Respektimi i të drejtave të punonjësve të medias në vendin e punës

Respektimi i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias në vendin e punës përbën një nga indikatorët më domethënës për gjendjen e përgjithshme të lirisë së medias dhe pavarësisë profesionale në Shqipëri. Përtej lirisë editoriale dhe presioneve politike, mënyra se si trajtohen gazetarët brenda redaksive, nga kontratat dhe pagesat, te kushtet psikologjike dhe garancia për dinjitet në vendin e punës, reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin e mjedisit mediatik.

Të dhënat e Barometrit Kombëtar të Lirisë së Medias 2024–2025 zbulojnë një panoramë me kontradikta të forta: në sipërfaqe, duket se ka një përmirësim të lehtë në formalizimin e marrëdhënieve të punës, por pas kësaj tabloje qëndron një realitet i përkeqësuar pasigurie, presioni dhe informaliteti të fshehur. Mungesa e kontratave afatgjata, pagesat e pjesshme apo jashtë banke, si dhe oraret e zgjatura të punës tregojnë se pasiguria dhe shfrytëzimi i fuqisë punëtore janë bërë pjesë e strukturës së përditshme të industrisë mediatike.

Kjo pasiguri në punë nuk ka pasoja vetëm ekonomike, por ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e gazetarisë. Në këtë kuptim, mungesa e garancive të punës nuk është vetëm çështje sociale, por një problem që prek

¹⁷ <https://www.reporter.al/2025/03/04/pa-mbeshtetje-dhe-nen-tryni-kriza-e-gazetarise-lokale-ne-shqiperi/>

drejtpërdrejt integritetin e informacionit publik dhe funksionimin e medias si pushtet i katërt.

Në shumë raste, këto kushte pune krijojnë terrenin për shkelje më të rënda të të drejtave në vendin e punës, duke përfshirë bullizmin, ngacmimet dhe presionet ekonomike si forma të heshtura kontrolli mbi gazetarët. Ky seksion analizon kushtet bazë të punësimit, duke përfshirë marrëdhëniet kontraktuale, orët e punës dhe mjedisin psiko-social në redaksi, duke u fokusuar në fenomenet e bullizmit dhe ngacmimit.

4.1 Informaliteti dhe kushtet e punës

Gjetjet e vitit 2024-2025 tregojnë një situatë me dy pamje kontradiktore. Ndërsa ka një numër më të madh gazetarësh që deklarojnë se kanë një kontratë pune, ka një përkeqësim të treguesve të informalitetit, duke sugjeruar se pasiguria kontraktuale mbetet një mjet kyç për ruajtjen e kontrollit mbi punonjësit e medias.

Kështu, ndonëse 85.6% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, shifra e atyre që pranojnë se nuk kanë një kontratë të rregullt është 12.9%. Ky tregues paraqet një përkeqësim të dukshëm krahasuar me gjetjet e Barometrit 2022-2023, ku kjo shifër ishte 9.9%, dhe atij të 2021, ku ishte vetëm 6%. Kjo rritje e informalitetit konfirmon se pasiguria është një problem në rritje.




Figura 1 Kontrata e punës.

Pasiguria përforcohet nga natyra e kontratave: vetëm 62.9% e të anketuarve kanë kontrata pa afat që është forma kontraktuale që inkurajohet nga parashikimet e Kodit të Punës (neni 140, pika 2), ndërsa një pjesë e konsiderueshme 17.3% operojnë me kontrata 1-vjeçare. 13.3% e gazetarëve apo punonjësve të medias nuk kanë një kontratë apo nuk e dinë nëse ka një të tillë.

Pavarësisht se ka një përmirësim nga 55% që ka qenë kjo e dhënë në vitet 2022-2023, numri i punonjësve të medias pa kontrata apo me kontrata afatshkurta mbetet i lartë. Një gazetar me kontratë afatshkurtër është strukturisht më i prirur t'u trembet presioneve editoriale dhe t'i nënshtrohet vetëcensurës, nga frika e mos-rinovimit.

10) A e merrni të plotë pagën tuaj në bankë?

202 responses




Figura 3 Format e pagesës.

Ky model i pasigurisë ekonomike thellohet nga praktikat e pagesave ende të parregulluara. Mbi 17.3% e të anketuarve raportojnë se nuk e marrin pagën e plotë në bankë, një ndryshim i vogël nga 18.4% në barometrin 2022-2023. Kjo praktikë, jo vetëm shmanget detyrimet fiskale, por i bën punonjësit më të cenuar ndaj presioneve dhe vonesave të pagesave. Kjo lidhet drejtpërdrejt me gjetjet e raporteve ndërkombëtare për kushtet e vështira të punës dhe pagat e ulëta.

4.2 E drejta për pushime javore dhe vjetore

Shfrytëzimi intensiv i fuqisë punëtore mbetet normë dhe shqetësim i madh në redaksitë shqiptare, çka krijon një terren të pafavorshëm për konsumimin e punonjësve të medias, uljen e produktivitetit të tyre në terma afatgjatë, duke sjellë ndikime negative tek shëndeti fizik, mendor dhe jeta personale. Mbi 60% e punonjësve të medias punojnë më shumë se 5 ditë në javë: 54% raportojnë se punojnë 6 ditë dhe 8.9% raportojnë se punojnë 7 ditë në javë. Këto shifra paraqesin një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2022-2023, ku 56.4% punonin 6 ditë dhe 11.5% punonin 7 ditë.

11) Sa ditë në javë punoni?

202 responses



Figura 2 Kohëzgjatja e punës dhe pushimet javore.

Megjithatë, situata mbetet problematike sa i përket pushimeve vjetore. Rreth 40% e të anketuarve nuk i gëzojnë pushimet e plota ligjore (të paktën 4 javë kalendarike në vit): 33.7% marrin vetëm 15 ditë, 3.5% nuk marrin pushime fare, dhe 4% marrin më pak se 10 ditë. Krahësuar me të dhënat e vitit 2022-2023, ku 54% e të anketuarve raportojnë se i merrnin pushimet e plota, gjetjet e këtij viti sugjerojnë një përkeqësim të respektimit të kësaj të drejte themelore të punës.

12) Sa ditë në vit merrni pushime të paguara?

202 responses




Figura 4 Pushimet vjetore.

4.3 Bullizmi/tallja në vendin e punës

Përqindja e të anketuarve që raportojnë se janë ndjerë të bullizuar ka rënë në 9.4%, nga 14.5% në raportin e 2022-2023. Megjithatë, të dhënat e reja cilësore të mbledhura në këtë Barometër zbulojnë se bullizmi nuk është thjesht një çështje e marrëdhënieve ndërpersonale, por një mjet i vetëdijshëm i menaxhimit dhe presionit ekonomik ndaj punonjësve të medias.

13) A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës në dy vitet e fundit? (Nëse jo kalo në pyetjen 16).

202 responses




Figura 5 Bullizmi.

Kur u pyetën për arsyet specifike pse ishin ndjerë të bullizuar, të anketuarit përmendën:

- Mungesën e mbështetjes: "nuk kam marrë ndihmë nga drejtuesit, por në vend të kësaj injorim dhe inferioritet".
- Presionin editorial: "bullizëm për mos-raportimin e informacionit siç dëshirohet nga autori i emisionit".
- Presionin ekonomik i lidhur me një të drejtë legjitime: Një nga përgjigjet më zbuluese ishte "të qenit i tallur për mos marrjen e pagesës në kohë".

Kjo mbështetet nga dëshmitë e atyre që kanë parë raste bullizmi. Të anketuarit raportuan se kishin parë "abuzim verbal (sharje dhe fyerje)" dhe në mënyrë specifike "pronarët që poshtërojnë kolegët për të shmangur rritjen e pagave". Këto gjetje e transformojnë bullizmin nga një sjellje thjesht "toksike" në një strategji të qëllimshme të menaxhimit, të krijuar për të maksimizuar kontrollin editorial dhe për të minimizuar kostot e punës.

4.4 Ngacmimet seksuale në vendin e punës

Ngacmimi seksual mbetet një çështje e nën-raportuar nga vetë viktimat në radhët e punonjësve të medias. Vetëm 2.5% e të anketuarve (5 persona) pohuan se e kishin përjetuar personalisht. Kjo shifër është në rënje krahasuar me 4% në 2021 dhe 7.5% në 2020.

Megjithatë, shifra e dëshmitarëve tregon një histori tjetër. Një përqindje më e lartë, 17.3% (35 persona), raportuan se kishin dëshmuar ose parë raste të ngacmimit seksual tek kolegët e tyre. Për më tepër, të dhëna të tjera cilësore tregojnë se disa të anketuar "kishin lexuar mesazhe ku pronarët ngacmonin seksualisht kolegët". Ky hendek i madh midis përjetimit të raportuar (2.5%) dhe dëshmisë (17.3%) dëshmon një klimë të fortë frike ose turpi që pengon vetë-raportimin.

Të dhënat e reja cilësore nga ata që pranuan të flisnin tregojnë përfshirjen e eprorëve në këtë fenomen përfshinin "Redaktorë/drejtorë të përfshirë në ngacmim tendencioz përmes mesazheve dhe fjalëve" dhe raste të "ngacmimit verbal të ndodhur para stafit". Këto gjetje konfirmojnë shqetësimet e ngritura nga raporte të specializuara, si ai i Rrjetit SafeJournalists për Sigurinë e Grave Gazetare¹⁸, i cili e identifikon këtë si një çështje kritike që prek sigurinë dhe integritetin.

4.5 Organizimi sindikal

Pyetjet e reja të shtuara në këtë Barometër mbi organizimin sindikal zbulojnë një hendek të thellë midis nevojës për përfaqësim kolektiv dhe realitetit të zymtë të frikës dhe mungesës së ndërgjegjësimit.

Në vitet e mëparshme (2022-2023), një shumicë dërrmuese (89%) e shihnin të nevojshme krijimin e një sindikate. Megjithatë, të dhënat e 2024-2025 tregojnë se, pavarësisht ekzistencës së një sindikate të re, mobilizimi deri tani ka dështuar:

- **Mungesa e ndërgjegjësimit:** 45% e të anketuarve nuk janë fare në dijeni të ekzistencës së sindikatës së re të gazetarëve.
- **Anëtarësimi i ulët:** Vetëm 21.8% e të anketuarve deklarojnë se janë aktualisht pjesë e një organizimi

¹⁸ Women Journalists' Safety: Albania Report 2024 - SafeJournalists, aksesuar më 3 Nëntor 2025, <https://safejournalists.net/publication/women-journalists-safety-albania-report-2024/>

sindikale apo një strukturë të ngjashme, si shoqata profesionale, unione apo rrjete që merren me mbrojtjen e të drejtave të punës dhe interesave të gazetarëve.

- **Hezitimi:** Edhe midis atyre që janë në dijeni, vetëm 59.4% shprehen të gatshëm të ishin pjesë aktive, ndërsa mbi 40% ose hezitojnë ("Nuk e di", 23.3%) ose refuzojnë (17.3%).

21) A jeni në dijeni që në Shqipëri është ngritur tashmë një sindikatë për punonjësit e medias (Sindikata e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias)?

202 responses




Figura 6 Njohuria mbi sindikatën.

Arsyeja e këtij dështimi për t'u organizuar kolektivisht bëhet e qartë kur analizohen të dhënat për aksesin në drejtësi (shih Seksionin 7.4). Frika nga hakmarrja e punëdhënësit (54%) dhe frika e futjes në "listën e zezë" (49.5%) krijojnë një "mur frike" që pengon çdo formë të veprimit kolektiv. Solidariteti i pronarëve kundër organizimit të punës me keqardhje vërejmë se duket të jetë më i fortë se solidariteti i gazetarëve për të drejtat e tyre.

A do të ishit ju vetë pjesë aktive e kësaj sindikate?

202 responses




Figura 7 Përgjigjet në pyetësin 22-23

22) A do të ishit ju vetë pjesë aktive e kësaj sindikate?

202 responses




Figura 8 Përgjigjet në pyetësin 24-25

5. Liria profesionale dhe siguria

Ky seksion analizon mjedisin profesional dhe personal të gazetarëve, duke u fokusuar në dy aspekte kryesore: rreziqet që lidhen me sigurinë e tyre dhe mirëqenien psikologjike.

Gjetjet e këtij Barometri tregojnë qartë se klima e presionit ndaj gazetarëve në Shqipëri nuk është përmirësuar¹⁹ por thjesht ka ndryshuar formë. Kjo klimë është zhvendosur nga format brutale të kërcënimit fizik drejt mekanizmave më të sofistikuar, por po aq efektivë, të kontrollit ligjor, ekonomik dhe menaxherial.

Në një kontekst ku gazetarët shpesh ekspozohen ndaj aktorëve me pushtet politik, ekonomik apo kriminal, siguria e tyre profesionale lidhet ngushtësisht me aftësinë për të qëndruar të pavarur dhe për të ruajtur integritetin editorial.²⁰ Megjithatë, të dhënat tregojnë se përballja e tyre nuk ndodh më vetëm në terren, përballë burimeve të lajmit, por edhe brenda institucioneve ku punojnë. Në shumë raste, presioni nuk vjen vetëm nga jashtë, por nga brenda redaksive, në formën e kërcënimeve të nënkuptuara, urdhrave për autocensurë, presioneve për kompromis profesional ose frikës nga humbja e vendit të punës.

Kjo pasiguri profesionale dhe ligjore ka një ndikim të matshëm në mirëqenien psikologjike. Seksioni thekson se stresi raportohet në nivele shumë të larta, duke prekur një përqindje të konsiderueshme të të anketuarve. Ky stres nuk buron vetëm nga mbulimi i ngjarjeve traumatike, por lidhet ngushtë edhe me kushtet e punës.

Së fundi, ky kapitull shqyrton mungesën e rrjeteve mbështetëse. Përballë këtyre sfidave, të dhënat tregojnë se gazetarët operojnë me mbështetje të kufizuar institucionale. Raportohet një mungesë e mbështetjes si nga punëdhënësit, ashtu edhe nga organizatat dhe sindikata, gjë që i ekspozon profesionistët e medias ndaj rreziqeve të përmendura.

¹⁹ <https://www.reporter.al/2025/11/05/ngacmimi-i-gazetareve-nga-zyrtaret-shqiptare-po-kthehet-ne-normalitet-shqetesues/>

²⁰ <https://www.reporter.al/2024/03/27/gazetaret-protestojne-kunder-rames-per-tkurrien-e-lirise-se-shprehjes/>

5.1 Kërcënimet për shkak të punës

Gjetjet e këtij viti tregojnë një ndryshim të dukshëm në natyrën e kërcënimeve. Nga njëra anë, raportimet për kërcënime fizike kanë pësuar një rënie. 14.4% e të anketuarve raportuan se janë ndjerë të kërcënuar fizikisht, një shifër më e ulët krahasuar me 20.3% të raportuar në Barometrin 2022-2023. Nga ana tjetër, kërcënimet verbale janë në rritje të ndjeshme. 37.1% e të anketuarve raportuan se janë kërcënuar verbalisht, një rritje e konsiderueshme nga 31.2% e raportuar në vitet 2022-2023.




Figura 9 Kërcënimet verbale dhe fizike 22-23 dhe 24-25

Analiza e re cilësore e këtyre kërcënimeve tregon se burimet e tyre janë të dyfishta:

1. **Burimi i jashtëm (tradicional):** Kërcënimet fizike lidhen me raportimin investigativ mbi “krimin e organizuar”, “bandat” dhe “vrasës të kërkuar”. Gjithashtu, ato lidhen me pushtetin politik dhe ekonomik, si “tenderët qeveritarë” dhe “kryetarët e bashkive”.
2. **Burimi i brendshëm (strukturor):** Kërcënimet verbale nuk vijnë më vetëm nga “militantë politikë” apo “familjarë të të arrestuarve”. Ato po marrin formën e presionit të sofistikuar. Të anketuarit raportuan në mënyrë specifike “paditë (SLAPP)²¹ nga zyrtarë publikë”. Akoma më shqetësues është fakti se kërcënimi verbal tani është gjithashtu një mjet i brendshëm menaxherial, i shprehur si “kërcënim me ndërprerjen e punës” ose “të thonë ‘bëje ose largohesh’”.

Kjo zhvendosje tregon një evolucion shqetësues të taktikave të kontrollit. Presioni po bëhet më pak i dhunshëm fizikisht, por më i përhapur ligjërisht dhe ekonomikisht. Kjo e bën më të vështirë për t'u gjurmuar dhe dokumentuar, por po aq efektiv në heshtjen e zërave kritikë.

²¹ <https://www.reporter.al/2025/10/21/flutura-kusari-be-ja-duhet-te-nderhyje-per-te-ndalur-bullizimin-ligjor-te-gazetareve-ne-ballkan/>

5.2 Stresi dhe situatat traumatike

Stresi mbetet një "epidemi" e paadresuar në profesionin e gazetarisë. Një nivel alarmant prej 85.1% e të anketuarve raportojnë se kanë përjetuar nivel të lartë stresi si pasojë e punës, një rritje e lehtë nga 81.2% e raportuar në 2022-2023.

Ky stres nuk buron vetëm nga mbulimi i ngjarjeve tronditëse. Edhe pse 46% kanë mbuluar ngjarje të tilla si vrasje apo aksidente të rënda, shkaku i stresit është po aq ekonomik sa edhe psikologjik. Të dhënat cilësore nga pyetjet e hapura e lidhin stresin drejtpërdrejt me kushtet e punës, si për shembull "detyrimi për të rritur ngarkesën e punës pa rishikim page".

Stresi i punonjësit të medias shqiptar nuk është vetëm stresi post-traumatik (PTSD) nga ngjarjet tronditëse, por stresi kronik i pasigurisë: ankthi i mos-pagesës, i pushimit nga puna dhe i brishtësis kontraktuale. Pavarësisht këtij niveli të lartë stresi, pothuajse askush nuk kërkon ndihmë. Është shumë shqetësuese shifra se 93.6% e të anketuarve deklaruan se nuk kanë kërkuar kurrë ndihmë mjekësore/psikologjike.

5.3 Mbështetja institucionale

Punonjësit e medias operojnë në një mjedis pa pothuajse asnjë rrjet sigurie. Kur përballen me kërcënime, mbështetja nga punëdhënësi është e pasigurt: vetëm 41.1% u përgjigjën "po", ndërsa një e treta (34.2%) u përgjigjën "nuk e di", duke treguar një mungesë të qartë të komunikimit dhe politikave mbrojtëse.

Mbështetja nga strukturat e jashtme është pothuajse inekzistente. 94.1% e të anketuarve nuk kanë kërkuar kurrë ndihmë nga OJF-të e medias. Një shifër në rritje nga 86.1 për qind në barometrin e kaluar, çka tregon një trend përkeqësues të mungesës së besimit në këto kanale të raportimit. Ata pak që kanë kërkuar ndihmë raportojnë rezultate të përziera nga organizatat vendase, ndërsa disa kanë gjetur mbështetje vetëm nga organizata ndërkombëtare.

6. Censura dhe vetëcensura

Gjetjet e këtij Barometri ofrojnë dëshmitë më të qarta deri më sot për mekanizmat e "kapjes së medias" dhe mënyrën se si ato ndikojnë drejtpërdrejt në lirinë e informimit. Të dhënat tregojnë një rritje të dukshme të censurës së drejtpërdrejtë, e cila është e përqendruar kryesisht në mbulimin e skandaleve të mëdha politike dhe të korrupsionit që përfshijnë figura të larta shtetërore ose interesa të fuqishme ekonomike.

Në shumë raste, ndërhyrjet editoriale ndodhin përmes urdhrave të drejtpërdrejtë nga drejtuesit e mediave ose përmes sinjaleve të nënkuptuara që gazetarët mësojnë t'i lexojnë me kohë. Kjo formë e censurës "nga lart-poshtë" shpesh shoqërohet me presion financiar, përmes varësisë së mediave nga reklamat shtetërore apo kontratat publike, çka e bën redaksinë më të ndjeshme ndaj interesave të pronarit apo të qeverisë.

Përballë këtij realiteti, shumë gazetarë raportojnë se janë detyruar të praktikojnë vetëcensurë, një proces i brendshëm autokontrolli për të shmangur tema, burime apo kënde raportimi që mund të sjellin pasoja për vendin e tyre të punës ose për ta personalisht. Vetëcensura është bërë një mekanizëm mbijetese në një mjedis ku mungojnë garancitë për pavarësi editoriale, ku pasiguria në punë është e lartë dhe ku reagimet ndaj raportimit kritik shpesh janë ndëshkuese.

Ky kombinim i censurës së strukturuar dhe vetëcensurës së përhapur krijon një cikël frike dhe heshtjeje që dëmton thellë cilësinë e gazetarisë, e kufizon debatin publik dhe zvogëlon aftësinë e medias për të ushtruar rolin e saj si rojtari i interesit publik.

6.1 Censura e drejtpërdrejtë: harta e temave të ndaluara

Censura e drejtpërdrejtë nga eprorët është në rritje. Përqindja e gazetarëve që raportojnë se punëdhënësi i ka ndaluar të publikojnë një lajm është rritur në 38.1%, nga 31% që ishte në raportin 2022-2023. Megjithatë ka një rënie të gazetarëve që raportojnë se janë urdhëruar të lënë përgjysmë një hulumtim nga 38.6 në 20.8 %. Kjo rënie mund të lidhet me përdorimin gjithnjë e më të shpeshtë të censurës parandaluese, ku gazetarët dekurajohen ose pengohen të nisin një hulumtim që në fazën e parë, duke e bërë të panevojshëm ndërhyrjen e drejtpërdrejtë për ta ndërprerë atë në mes.

Figura 10 Krahimi i censurës në dy barometra.

Krahimi i censurës së drejtpërdrejtë (2022-2023 vs. 2024-2025)	2022-2023	2024-2025
Lloji i censurës		
Ndalimi i publikimit të një lajmi (nga eprori)	31%	38.1%
Urdhërimi për të lënë përgjysmë hulumtimin	38.6%	20.8%

Zbulimi më i rëndësishëm i këtij raporti vjen nga të dhënat cilësore, të cilat tregojnë saktësisht çfarë po censurohet:

- **Rastet e ndalimit të publikimit:** Të anketuarit përmendën në mënyrë specifike "lajme kritike ndaj qeverisë", lajme për politikanë të ndryshëm kryesisht në pushtet dhe skandale të profilit të lartë si ai i "Incineratorëve", "Skandali i spitalit Onkologjik", "Skandali TIMS" dhe "Veliaj" e "Arrestimet e drejtorëve të Bashkisë Tiranë".
- **Rastet e ndalimit të hulumtimit:** Lista vazhdon me tema si "qeverinë, politikën... oligarkët", "Inceneratori i Tiranës", "projekti i Aeroportit të Vlorës" dhe "dosje të hetuara nga SPAK".

Kjo listë përbën një "hartë të censurës". Ajo provon, përmes vetëraportimit të gazetarëve, se pronarët e medias po veprojnë aktivisht për të mbrojtur interesa të fuqishme politike, qeveritare dhe ekonomike. Kjo është dëshmia më e qartë e "kapjes së medias" për të cilën flasin raportet ndërkombëtare.



202 responses



Kur u pyetën se çfarë përmbajtjeje kishin këto materiale të gatshme, të anketuarit ishin të qartë: 40.9% e identifikuan si “Propagandë ose material promovues” dhe 32.7% si “Informacion zyrtar / deklaratë institucionale”. Kjo tregon se media nuk po dështon thjesht në rolin e saj si “rojtare apo vëzhguese”; ajo po përdoret në mënyrë aktive si “zëdhënëse” për të shpërndarë propagandë të paverifikuar.

6.3 Vetëcensura

Në këtë mjedis të censurës së hapur dhe propagandës së detyruar, vetëcensura bëhet një mekanizëm mbijetese. Gjetjet tregojnë se ky është një problem kronik dhe i pandryshuar, i rrënjësor kryesisht në hierarkinë e brendshme të redaksisë.

46.5% e gazetarëve pranojnë se kanë shmangur raportimin e një lajmi nga frika e eprorit. Kjo shifër është pothuajse identike me atë të vitit 2022-2023 (47.0%), duke treguar se presioni i brendshëm editorial është konstant.

46) A ju ka ndodhur që të keni shmangur raportimin e një lajmi sepse keni menduar se publikimi i tij nuk do t'i pëlqejë punëdhënësit/redaktorit tuaj?

202 responses




Figura 13 Vetëcensura.

Burimi i frikës është i qartë. Më shumë gazetarë kanë frikë nga pasojat profesionale sesa ato ligjore:

- 32.7% kanë frikë se publikimi i një lajmi mund t'i pushojë nga puna.
- Vetëm 10.9% janë tërhequr nga frika se do të paditen (SLAPP).

Kur u pyetën në mënyrë specifike (në një shkallë nga 1 në 5) se sa ndikon frika e humbjes së punës në raportimin e tyre, 47.1% e vlerësuan atë si një ndikim të lartë (nota 3, 4 ose 5). Kjo konfirmon se kërcënimi kryesor për lirinë e gazetarit nuk vjen nga jashtë (gjykatat), por nga brenda (redaktori dhe pronari).

7. Vlerësimi i përgjithshëm mbi lirinë e medias

Pjesa e fundit e pyetësorit ofron një diagnozë të detajuar të sektorit nga vetë profesionistët, duke identifikuar shkaqet rrënjësore të krizës dhe zgjidhjet e mundshme. Këto të dhëna konfirmojnë perceptimin negativ dhe në përkeqësim të lirisë së medias, ndërkohë që gazetarët e identifikojnë problemin si thelbësisht strukturor, politik dhe ekonomik.

Ata e përkufizojnë shkakun kryesor si "kapjen e medias" nga një ndërthurje e interesave politike dhe të biznesit. Ky model, sipas të anketuarve, prodhon pasoja direkte si rënia e cilësisë së gazetarisë, e cila nuk i atribuohet mungesës së aftësive profesionale, por ndërhyrjeve politike, kushteve të punës, pagave të ulëta dhe mungesës së pavarësisë editoriale.

52) Si e vlerësoni lirinë e medias në Shqipëri në periudhën 2024-2025?

202 responses




Figura 14 Vlerësimi për lirinë.

Shumica dërrmuese e të pyeturve vijojnë të tregojnë politikën dhe politikanët si faktorë kryesorë që pengojnë lirinë e gazetarëve. Ata listuan si probleme sulmet verbale nga personat me profil të lartë politik dhe në disa raste sulmet e perceptuara të drejtpërdrejta ndaj lirisë së medias si dëbimi i menjëhershëm i gazetarëve të Focus Media Group nga godina apo veprime të ngjashme.

Ky model krijon një mjedis ku gazetarët hezitojnë t'i drejtohen gjykatave për të drejtat e tyre të punës, për shkak të shqetësimeve për pasojat nga punëdhënësi aktual apo për mundësitë e ardhshme të punësimit, për shkak të vijueshmërisë së solidarizimit mes pronarëve të medias.

Në këtë kontekst, zhvillimet e pakta pozitive të cituara janë kryesisht faktorë të jashtëm, si presioni ndërkombëtar, mbështetja e donatorëve apo veprimet e institucioneve të drejtësisë. Rrjedhimisht, zgjidhjet e propozuara nga profesionistët nuk përqendrohen tek trajnimet, por tek adresimi i kësaj kapjeje strukturore, duke sugjeruar forcimin e pavarësisë financiare të gazetarëve, mbrojtjen kolektive përmes sindikatave dhe krijimin e modeleve alternative të pronësisë së medias.

7.1 Perceptimi i lirisë dhe tendenca

Perceptimi i gazetarëve për lirinë e medias në tërësi mbetet thellësisht negativ. 70.8% e të anketuarve e vlerësojnë median në Shqipëri si "Pak të lirë" (43.1%) ose "Aspak të lirë" (27.7%). Ky tregues paraqet një përmirësim të lehtë statistikor nga 81% që e vlerësonin si të tillë në 2022-2023.

Edhe numri i atyre që vlerësojnë se media është mesatarisht e lirë u rrit në 23.3% nga 15.8% që ishte në pyetësin e mëparshëm. Numri i atyre që e shohin median tërësisht të lirë u rrit nga 5 në 10 të pyetur prej grupit prej 202 përgjigjesh.

Megjithatë, ky përmirësim i lehtë statistikor hidhet poshtë nga pyetja pasuese për tendencën. Kur u pyetën për drejtimin e ndryshimit, një shumicë dërrmuese prej 58.4% deklaruan se liria e medias është përkeqësuar. Vetëm 11% panë një përmirësim.

53) Në raport me vitet e shkuara, a mendoni se liria e medias në dy vitet e fundit:

202 responses




Figura 15 Perceptimi mbi lirinë e medias.

Kjo kontradiktë sugjeron se ndërsa gjendja e përgjithshme mund të ketë kaluar nga “aspak” në “pak” e lirë për disa, tendenca aktive dhe përvoja e jetuar, e cila sipas 55.4% të të anketuarve është baza e vlerësimit, është negative. Ky perceptim mund të ndikohet edhe nga rënia e rasteve të sulmeve fizike ndaj gazetarëve, çka mund të krijojë një ndjesi të rreme përmirësimi dhe një kuptim jo plotësisht të saktë të vetë punonjësve të medias se çfarë përbën realisht një media e lirë.

7.2 Faktorët ndikues

Gazetarët japin një diagnozë të qartë të krizës së medias. Të lexuara së bashku, pyetjet cilësore mbi shkaqet e krizës, tregojnë se gazetarët e identifikojnë problemin të politikës dhe interesat e biznesit dhe po ashtu e shohin zgjidhjen të një pavarësi më të madhe.




Figura 16 Faktorët pengues.

Zgjidhja: Rrjedhimisht, zgjidhjet e propozuara janë ato që ofrojnë pavarësi nga këta dy aktorë (qeveria dhe

pronarët e biznesit).

Figura 17 Faktorët përmirësues.

Faktorët që do të ndihmonin lirinë e medias	
Faktori	Përqindja
Mbështetja e mediave nga donacionet e huaja	55.4%
Krijimi i sindikatave në mbrojtje të gazetarëve	54.5%
Rritja e përgatitjes profesionale të gazetarëve	49.5%
Krijimi i mediave në pronësi dhe drejtim të vetë gazetarëve	48.0%

Këto të dhëna tregojnë se gazetarët e identifikojnë problemin si strukturor, politik dhe ekonomik dhe jo thjesht si një çështje trajnimi (i cili renditet i treti). Kjo mbështet plotësisht gjetjet e Komisionit Evropian dhe SCiDEV për "përqendrimin e tregut" dhe "mbivendosjen e interesave të biznesit dhe politikës".



Figura 18 Fjalët kyç të përmendura nga të pyeturit në lidhje me mungesën e lirisë në media.

7.3 Ngjarjet kryesore dhe zhvillimet pozitive

Kur u pyetën për ngjarjet më të rënda që cenojnë lirinë, të anketuarit identifikuan presionet politike dhe

sulmet si shqetësimet kryesore:

1. Kërcënimet dhe presionet publike nga politikanë: 59.9%
2. Kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve: 47.0%
3. Sulmet ndaj redaksive (p.sh., rasti Focus Media Group): 44.1%
4. Sulmet ndaj emisioneve investigative: 38.6%

Në të kundërt, kur u pyetën për zhvillimet pozitive, shumë të anketuar u përgjigjën "Asnjë" ose "Është përkeqësuar". Të paktët faktorë pozitivë të cituar ishin pothuajse të gjithë të jashtëm ndaj mjedisit të medias:

- “Aksionet e SPAK” dhe “arrestimi i politikanëve të profilit të lartë”.
- “Miratimi i Aktit Evropian për Lirinë e Medias (EMFA)”.
- “Mbështetja nga donatorët e huaj” dhe “puna individuale e gazetarëve të guximshëm”.

Kjo tregon se liria e medias në Shqipëri nuk po përmirësohet nga vetërregullimi apo etika e brendshme e pronarëve. Përkundrazi, çdo hapësirë e fituar është një efekt anësor i reformës në drejtësi dhe presionit ndërkombëtar, të cilat u kanë dhënë gazetarëve më shumë hapësirë për të raportuar mbi korrupsionin, shpesh pasi SPAK ka vepruar i pari.

7.4 Aksesit në drejtësi

Pyetja e re (*Cilat janë arsyet që pengojnë gazetarët t'i drejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cenohet?*) zbulon rrënjën e problemit pse shkeljet e të drejtave të punës dhe informaliteti vazhdojnë pa u ndëshkuar: një kod heshtjeje i imponuar nga pronarët, e cila e bën aksesin në drejtësi një "vetëvrasje" profesionale.

Arsyet që pengojnë gazetarët t'i drejtohen gjykatës	
Arsyeja	Përqindja
Burokracitë në përballjen me gjykatën	56.4%
Frika nga hakmarrja e punëdhënësit	54.0%
Frika se nuk do të punësohet nga punëdhënësi tjetër (lista e zezë)	49.5%
Mungesa e të ardhurave	37.6%

Figura 19 Arsyet e mungesës së padive.

Ndërsa burokracia është arsyeja më e cituar, dy arsyet vijuese: frika nga hakmarrja (54%) dhe frika e futjes në "listën e zezë" (49.5%), janë domethënëse. Këto dy frikëra, të kombinuara, tregojnë një solidaritet të fortë mes pronarëve të medias për të ndëshkuar çdo gazetar që kërkon të drejtat e tij ligjore. Kjo shpjegon

plotësisht mungesën e suksesit deri më tani të lëvizjeve të sindikalizmit dhe konfirmon gjetjet e SCiDEV-BIRN se "shumë gazetarë hezitojnë të dalin përpara për shkak të frikës nga pasojat dhe shqetësimeve për mundësitë e ardhshme të punësimit".

7.5 Perceptimi mbi gazetarinë cilësore

Rënia e cilësisë së gazetarisë perceptohet gjerësisht nga të pyeturit. Mbi gjysmën e të anketuarve (51.5%) mendojnë se gazetaria cilësore ka qenë më pak e pranishme dy vitet e fundit, ndërsa vetëm 21.3% besojnë se ajo është bërë më e dukshme.

Krahasuar me Barometrin e kaluar, të dy treguesit kanë pësuar ndryshime. Përqindja e atyre që vlerësojnë se cilësia e raportimit është përkeqësuar është rritur nga 43.6% në vitin 2023, ndërsa është shtuar edhe numri i atyre që shohin një përmirësim, nga 16.8% në vitin 2023.

Ajo që bie në sy është se sipas gazetarëve, ky nuk është një problem aftësie, por një problem ekonomik dhe strukturor. Kur u pyetën se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar cilësinë, përgjigjet më të votuara nuk ishin "trajtime" (49.0%), por: Rritja e pagave dhe kushteve të punës (79.2%); Forcimi i pavarësisë editoriale nga politika/biznesi (64.4%).

Në mënyrë të ngjashme, për të pasur më shumë shkrime cilësore, gazetarët kërkuar: Mbështetje financiare për reportazhe të thelluara (66.8%); Sigurimi i më shumë kohe dhe burimeve për hulumtim (61.4%). Modeli aktual i biznesit të medias bazohet në kosto të ulët (paga të ulëta, pa kohë për hulumtim) dhe kontroll të lartë (pa pavarësi editoriale). Gazetarët detyrohen të prodhojnë lajme të shpejta dhe propagandë sepse u mungojnë mjetet (koha, paratë, pavarësia) për të bërë gazetari cilësore. Rrjedhimisht, rënia e cilësisë nuk është një dështim i gazetarëve, por i strukturës dhe modelit problematik mediatik.

8. Rekomandime

Bazuar në të dhënat e anketës dhe analizën e detajuar të gjetjeve, duke ndjekur praktikën e Barometrave të mëparshëm, KShH sugjeron rekomandimet e mëposhtme, drejtuar aktorëve kryesorë përgjegjës për mjedisin mediatik në Shqipëri:

8.1 Rekomandime për përfaqësuesit e organeve publike dhe partive politike

Të ndalen presionet ndaj medias: Të shmanget çdo formë presioni dhe të dënohet publikisht përdorimi i gjuhës denigruese, kërcënimeve verbale apo sulmeve nga zyrtarë të lartë dhe politikanë ndaj gazetarëve, një praktikë e raportuar gjerësisht si pengesa kryesore për lirinë e medias.

Të adresohen paditë SLAPP: Të merren masa legjislative për dekriminalizimin e plotë të shpifjes, në përputhje me standardet evropiane, dhe të krijohen mbrojtje kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP), të cilat u raportuan nga gazetarët si një formë kërcënimi verbal.

Rritja e transparencës së financimit: Të zbatohen mekanizma ligjorë që detyrojnë transparencën e plotë të pronësisë së medias dhe të të gjitha burimeve të financimit, veçanërisht të fondeve publike dhe reklamave qeveritare, për të adresuar problemin e interesave të bizneseve dhe mbivendosjes së interesave.

Të forcohet pavarësia e AMA-s: Të rishikohen procedurat e emërimit në bordin e AMA-s për të garantuar pavarësi të plotë politike dhe korporative, duke iu përgjigjur shqetësimeve të vazhdueshme mbi ndikimin politik dhe ekonomik.

Aktivizimi i Inspektoratit të Punës: Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të ndërmarrë inspektime rigorozë dhe proaktive në redaksitë e medias për të hetuar shkallën e lartë të informalitetit, mospagesën e plotë në bankë të pagës, të pagesës periodike të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe shkeljet e të drejtave të pushimeve javore dhe vjetore.

8.2 Rekomandime për pronarët e medias

Formalizimi i menjëhershëm: Të sigurohet formalizimi i 100% të stafit editorial dhe teknik me kontrata të rregullta pune, duke eliminuar praktikën e punës pa kontratë dhe duke ofruar kontrata pa afat për të ulur pasigurinë.

Respektimi i kushteve të punës: Të sigurohet pagesa e plotë dhe në kohë e pagës përmes sistemit bankar dhe të respektohet në mënyrë rigorozë Kodi i Punës për ditët e pushimit javor dhe pushimet vjetore.

Të ndërpritet censura editoriale: Të ndalohet praktika e ndalimit të publikimit të lajmeve me interes të lartë publik, veçanërisht atyre që lidhen me korrupsionin qeveritar dhe zyrtarët e lartë.

Të ndalohet propaganda e detyruar: Të ndërpritet praktika joetike e detyrimit të gazetarëve për të publikuar materiale të paverifikuara, propagandë ose deklarata zyrtare pa kontroll faktik.

Krijimi i mekanizmave mbrojtës: Të krijohen mekanizma të brendshëm, efektivë dhe konfidencialë për raportimin dhe ndëshkimin e bullizmit dhe ngacmimit seksual, me fokus të veçantë të mbrojtja e punonjësve nga abuzimi i pushtetit prej eprorëve.

8.3 Rekomandime për Sindikatën e Gazetarëve si dhe organizatat e shoqërisë civile vendase dhe huaja

Fushata ndërgjegjësimi: Të ndërmerret një fushatë masive ndërgjegjësimi drejtuar gazetarëve për të informuar mbi ekzistencën, misionin dhe të drejtat që ofron sindikata e re, duke adresuar boshllëkun e informacionit të raportuar nga një pjesë e madhe e të anketuarve.

Mbrojtje ligjore konfidenciale: Të ofrohet mbështetje ligjore falas, konfidenciale dhe e specializuar për të adresuar frikën nga hakmarrja. Kjo duhet të fokusohet te mbrojtja e gazetarëve nga pushimet e padrejta dhe hakmarrja e punëdhënësit.

Mbështetje për gazetarinë cilësore: Të krijohen dhe të zgjerohen fondet e mbështetjes direkte për gazetarinë investigative dhe reportazhet e thelluara, duke iu përgjigjur nevojës së qartë për më shumë mbështetje financiare, kohë dhe burime.

Mbështetje për mirëqenien mendore: Duke pasur parasysh nivelin e lartë të stresit në sektor dhe mungesën totale të kërimit të ndihmës, OJF-të duhet të ofrojnë shërbime të mbështetjes psikologjike falas, të aksesueshme dhe konfidenciale për punonjësit e medias.

Rritja e mbështetjes së drejtpërdrejtë: Të vazhdohet dhe të rritet mbështetja financiare e drejtpërdrejtë për median e pavarur, gazetarët individualë dhe projektet investigative, një përgjigje ndaj kërkesave të shumta për mbështetje strukturore.

Monitorimi i zbatimit të EMFA: Të monitorohet në mënyrë rigorozë zbatimi real i standardeve të Aktit Evropian për Lirinë e Medias (EMFA) në Shqipëri.